

KONTRATË    THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"EREDA" SHPK



Personat që firmosin më poshtë:

Z.Edmond Gjoka, i biri i Vasilit, i dt.1960, lindur e banues në qytetin e Sarandës, me zotësi për të vepruar.

Z.Albert Gjoka, i biri i Vasilit, i dt.1962, lindur e banues në qytetin e Sarandës, me zotësi për të vepruar.

Z.Alqi Gjoka, i biri i Vasilit, i dt.1967, lindur e banues në qytetin e Sarandës, me zotësi për të vepruar,

kanë hartuar si më poshtë vijon kontratën e themelimit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, të cilën janë marrë vesh t'a themelojnë mes tyre.

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar vepron në bazë të dispozitave në ligjore në fuqi si dhe në bazë të statutit që i bashkëngjitet këtij akti.

Emërtimi i shoqërisë është "EREDA" SH.P.K Sarandë.

Objekti i shoqërisë "EREDA" SHPK Sarandë është:

- Eksport ~~import~~ të të gjitha llojeve të mallrave, industriale, bujqësore, blegtorale, artikuj elektronikë dhe elektroshtëpiakë,
- Aktivitet në fushën e investimeve dhe shërbimeve turistike,
- Aktivitet në fushën e ndërtimit,
- rumbullim dhe shitje të prodhimeve të detit, mishit etj.

Relia e shoqërisë do të jetë në lagjen nr.1 të qytetit të Sarandës

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë,

ky kapital përbëhet nga kontributet e mëposhtme:

z.Edmond Gjoka kontribon me shumën prej 34.000 lekë

z.Albert Gjoka kontribon me shumën prej 33.000 lekë

z.Alqi Gjoka kontribon me shumën prej 33.000 lekë.

Kapitali themeltar i shoqërisë është i ndarë në 100 pjesë; plotësisht të shlyera; me vlerë 1000 lekë secila, të renditura sipas numrit të serisë nga 1 në 100.

*Edmond*

%

*Albert*

*Alqi*

Në bazë të kontributeve të lartë përmendura:

z.Edmond Gjoka merr 34 pjesë të kapitalit themeltar, të renditura nga numri 1 i serisë deri në 34 për kontributin e tij në para;

z.Albert Gjoka merr 33 pjesë të kapitalit themeltar, të renditura nga numri 35 i serisë deri në numrin 68 për kontributin e tij në para;

z.Alqi Gjoka merr 33 pjesë të kapitalit themeltar, të renditura nga numri 68 i serisë deri në numrin 100 për kontributin e tij në para;

Të gjitha pjesët e kapitalit themeltar janë nënshkruar, shlyer plotësisht dhe janë shpërndarë ndërmjet ortakëve si më lartë.

Shoqëria do të administrohet nga një administrator i vetëm.

Administratori i parë i emëruar është z.Edmond Gjoka, me një mandat 2 vjeçar dhe me të drejtë rizgjedhje.

z.Edmond Gjoka i jep të gjitha kompetencat, për të kryer të gjitha veprimet sipas legjislacionit në fuqi.

Kjo kontratë Themeluese është hartuar në Sarandë më 5.1.1995, në katër kopje, në gjuhën shqipe, duke pasur të gjitha fuqi të barabart ligjore.

**O R T A K Ë T**

1.Edmond Gjoka



2.Albert Gjoka



3.Alqi Gjoka



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

NOTERIA SARANDË

Nr. 45 rep

Nr. 14 kol

**V È R T E T I M**

Sot më datë 5.1.1995, ditë e shtunë, para meje noterit E paraqitën personalisht z.Edmond Gjoka, z.Albert Gjoka, z.Alqi Gjoka, të gjithë banues në Sarandë, madhorë e të aftë për të vepruar, të njohur prej meje. Ata deklaruan se kontrata e themelimit është hartuar dhe nënshkruar prej tyre me vullnet të lirë. Unë noterit e vërtetoj sipas ligjit.

NOTER

Aleko Anagnosti



S T A T U T  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
" EREDA " SHPK



Personat që firmosin më poshtë:

z.Edmond Gjoka, i biri i Vasilit, i dt.1960, lindur e banues në Sarandë, madhor me zotësi për të vepruar.

z.Albert Gjoka, i biri i Vasilit, i dt.1962, lindur e banues në Sarandë, madhor me zotësi për të vepruar.

z.Alqi Gjoka, i biri i Vasilit, i dt.1967, lindur e banues në Sarandë, madhor e me zotësi për të vepruar.

kanë hartuar si më poshtë vijon Statutin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, të cilën janë marr vesh t'a themelojnë midis tyre.

K R E U \_ I

FORMA, EMËRTIMI I SHOQËRISË, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA.

\_ N E N I \_ 1 \_

Forma

Ndërmjet firmuesve të kontratës së themelimit është krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe me dispozitat e këtij statuti.

\_ N E N I \_ 2 \_

Emërtimi i shoqërisë

Emërtimi i shoqërisë është "EREDA" SHPK

\_ N E N I \_ 3

Objekti i shoqërisë

Objekti i shoqërisë është:

- Eksport import të të gjitha llojeve të mallrave industriale, bujqësore e blegtorale, artikuj elektronikë dhe elektroshtëpiakë,
- Aktivitet në fushën e inventimeve dhe shërbimeve turistike,
- Aktivitet në fushën e ndërtimit,
- Grumbullim dhe shitje të prodhimeve të detit, misht etj.

\_ N E N I \_ 4

Selia e shoqërisë

Selia e shoqërisë është në qytetin e Sarandës, në lagjen nr.1

*Edmond*

\_ N E N I \_ 5 \_

*Alqi*

*Albert*

\_\_NENI 5\_\_

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë është përcaktuar për një periudhë prej 10 vjetësh duke filluar nga regjistrimi në regjistrin tregëtar.

Kjo periudhë mund të zgjatet tej këtij afati ose të shkurtohet kur shoqëria prishet para kohe.

\_\_K R E U\_\_ \_\_II\_\_

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESËT E KAPITALIT THEMELTAR

\_\_NENI 6\_\_

Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar është 100.000 lekë, plotësisht të shlyeshme, me vlerë 1000 lekë secila, të renditura sipas numrit të serisë nga 1 deri në 100.

Në rast zmadhimi të kapitalit themeltar nëpërmjet shtimit të pjesëve të tjera, ortakët kanë të drejtën e përparësisë së nënshkrimit; porcionalisht me shumën e pjesëve të tyre.

\_\_NENI 7\_\_

Kontributet

Kapitali themeltar përbëhet nga kontributet e mëposhtme:

z. Edmond Gjoka	kontribon me shumën prej	34.000 lekë
z. Albert Gjoka	kontribon me shumën prej	33.000 lekë
z. Alqi Gjoka	kontribon me shumën prej	33.000 lekë

\_\_NENI 8\_\_

Pjesët e kapitalit themeltar

Në bazë të kontributeve të lartpërmendura:

z. Edmond Gjoka merr 34 pjesë të kapitalit themeltar të renditura nga numri i serisë 1 deri në numrin 34 të serisë për kontributin e tij në para.

z. Albert Gjoka merr 33 pjesë të kapitalit themeltar të renditura nga numri i serisë 35 deri në numrin e serisë 68 për kontributin e tij në para.

z. Alqi Gjoka merr 33 pjesë të kapitalit themeltar të renditura nga numri i serisë 68 deri në numrin e serisë 100 për kontributin e tij në para.

Të gjithë pjesët e kapitalit themeltar; nënshkruhen, shlyen plotësisht dhe pastaj shpërndahen nëpërmjet ortakëve sipas ndarjes së mësipërme.

*Edmond*

%

*Alqi*

*Albert*

\_\_NENI 9\_\_

Lënia dhe transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar  
Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, me rrugë trashigimie, në rast ndarje pasurore mes bashkëshortëve dhe ndërmjet pasardhësve.

Pjesët e kapitalit themeltar mund t'ju transferohen të tretëve vetë, me miratim të ortakëve që zotërojnë mbi 3/4 e pjesëve dhe me kushte jo më të favorshme se ato me të cilat u janë ofruar më parë ortakëve të tjerë.

\_\_K\_R\_E\_U\_\_ \_\_III\_\_

MARRJA E VENDIMEVE ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I SHOQËRISË

\_\_NENI 10\_\_

Ortakët dhe Asambleja e Ortakëve

Ortakët e shoqërisë përballojnë humbjet e saj deri në kufirin e vlerës së kontributeve të tyre në kapitalin fillestar.

Cdo ortak ka të drejtë të marr pjesë në mbledhjet dhe vendimet e Asamblesë dhe disponon një numër votash të barabartë me pjesët e kapitalit themeltar që ai zotëron. Në ushtrimin e detyrës (e së drejtës) së tyre për të marrë pjesë në vendimet kolektive, çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet me një ortak tjetër.

Mbledhja e Asamblesë mund të thirret nga një ose dy ortakë që zotërojnë mbi 1/10 pjesë të kapitalit themeltar, nga administratori, nga eksperti kontabël ose likujduesit.

Mbledhja mund të jetë e zakonshme ose e jashtëzakonshme, sipas rrethësive të vendimeve.

Asambleja e zakonshme vendos për çështje të tilla si si : emërimin dhe shkarkimin e administratorëve , ekspertëve kontabël të autorizuar dhe likujduesve, miratimin e raporteve të administrimit dhe kontrollit, miratimit i llogarive vjetore dhe ndarjes së fitimit e tjera.

Asambleja e jashtëzakonshme vendos për çështje të tilla si ndryshimet e statutit , zvogëlimi i kapitalit themeltar, transferime i pjesëve të kapitalit themeltar tek të tretët, zgjatja e afatit të veprimtarisë së shoqërisë apo likujdimit i saj , shëndrimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri të formave të tjera etj.

Asambleja e zakonshme në mbledhjen e parë të saj mund të marr vendime të vlefshme në qoftëse janë të pranishëm ose të përfaqësuar një numër ortakësh që zotërojnë mbi 1/2 e pjesëve të kapitalit themeltar. Në qoftëse mbledhja e parë e zakonshme nuk realizohet atëhere

*[Signature]*

*[Signature]*

*[Signature]*

thuret mbledhja e dytë e cila mund të marrë vendime të vlefshme, pamvarësisht sa pjesë të kapitalit themeltar zotërojnë ortakët e pranis shëm.

### NENI 11

#### Administrimi

Shoqëria administrëhet nga një adminsitrator i vetëm që është ortak në shoqëri.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me miratim të shumicës së ortakëve. Emërimi bëhet për dy vjet me të drejtë rizgjedhje, me përjashtim të rasteve të parakohshme si dorëheqje e shkarkim.

Në marrëdhëniet me ortakët dhe të tretët administratori ka të drejtë dhe kompetencë për të kryer të gjitha veprimet e administrimit në inters të shoqërisë dhe në emër të saj, nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e shoqërisë.

Administratori është përgjegjës ndaj shoqërisë dhe të tretëve për çdo shkelje qoftë.

Administratori ka të drejtë të delegojë një pjesë të kompetencave të tij një ortaku tjetër me anë të një akti me shkrim.

### NENI 12

#### Eksperti kontabël i autorizuar

Kontrolli i shoqërisë kryehet nga një ekspert kontabël i autorizuar i emëruar për tre vite financiarë mundësi rizgjedhje nga ortakët që përfaqësojnë mbi 1/2 e kapitalit themeltar.

Shkarkimi i ekspertit kontabël të autorizuar vendoset në të njëjtat kushte si emërimi, në rast se vërehen gabime ose bëhet e pamundur kryerja e detyrës.

### K R E U IV

#### VITI FINANCIAR LLOGARITË VJETORE NDARJA E FITIMEVE

### NENI 13

#### Viti financiar ,llogaritë vjetore

Çdo vit financiar fillon më 1 Janar e përfundon më 31 Dhjetor.

Llogaritë vjetore ,inventari ,raportet mbi operacionet financiare dhe raportet e veçanta të hartuara nga administratorët dhe eventualis nga eksperti kontabël i autorizuar, miratohen nga mbledhja e Asamblesë me miratim të ortakëve që zotërojnë mbi 1/2 e pjesëve të kapitalit themeltar.

Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhen brenda një afati prej 6 muajve nga data e mbylljes së viti financiar.

*Admon*

%

*Aljsh*

*10/10*

\_\_ NENI 14 \_\_

Dividentët

Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së fitimeve, Asambleja e ortakëve përcakton pjesën që u takon ortakëve në formën e dividendit mbi fitimin. Fitimi që do të ndahet ndërmjet ortakëve në formën e dividendit përbëhet nga fitimi i viti financiar, të cilit i është zbritur shuma e lënë mënjanë për fonde rezervë të domosdoshme (5% e fitimit të vitit derisa ky të arrij vlerën 1/10 të kapitalit themeltar) dhe nga ana tjetër i janë zbritur ose i janë shtuar respektivisht humbjet ose fitimet e mbartura nga vitat e mëparshme.

\_\_ K R E U V \_\_

ZGJATJA E AFATIT PRISHJA DHE LIKUJDIIMI I SHOQËRISË

\_\_ NENI 15 \_\_

Zgjatja e afatit, me përfundimin e afatit të përcaktuar në nenin 5 të këtij statuti mund të vendoset nga Asambleja me miratim të ortakëve që zotërojnë mbi 3/4 e pjesëve të kapitalit themeltar.

\_\_ NENI 16 \_\_

Prishja

Shoqëria priset me përfundimin e afatit të përcaktuar në nenin 5 të këtij statuti, me përjashtim të rasteve ku bëhet zgjatja e tij sipas nenit 15 ose kur ka një prishje të parakohshme për arsye të parashikuara në ligj.

Shoqëria nuk priset kur njëri prej ortakëve falimenton, bëhet i paafte ose vdes.

\_\_ NENI 17 \_\_

Likujdimi

Shoqëria hyn në procesin e likujdimit qysh në momentin e prishjes së saj. Pas shlyerjes së pjesëve të kapitalit të kontribuesve përkatës likujduesi ndan kapitalet e mbetura ndërmjet ortakëve sipas pjesëve që ata kanë në kapitalin themeltar.

\_\_ NENI 18 \_\_

Mosmarrëveshjet

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë apo gjatë prishjes së saj do të zgjidhen nga Gjykata kompetente shqiptare/

Ky statut u hartua në katër kopje në gjuhën shqipe, në datë 5.1.1995 në Sarandë, duke patur të gjitha të njëjtën fuqi ligjore.

*[Signature]*

*[Signature]*

*[Signature]*

O R T A K Ë T

1. Edmond Gjoka

*Edmond Gjoka*

2. Albert Gjoka

*Albert Gjoka*

3. Alqi Gjoka

*Alqi Gjoka*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

NOTERIA SARANDË

Nr. 45 rep

Nr. 14kol

V È R T E T I M

Sot më datë 5.1.1995, ditë e shtunë, para meje noterit u paraqitën personalisht z. Edmond Gjoka, z. Albert Gjoka, z. Alqi Gjoka, të gjithë banues në Sarandë, madhorë e të aftë për të vepruar, të njohur prej meje. Ata deklaruan se statutin e kanë hartuar dhe nënshkruaar vetë me vullnetin e tyre të lirë. Unë noteri e vërtetoj sipas ligjit.

N O T E R



*Aleko Anagnosti*

*Aleko Anagnosti*